

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË BANKËN E SHQIPËRISË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Bankën e Shqipërisë me objekt : “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare, për periudhën 1/1/2011 deri më 31/12/2011” dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 93 datë 26/06/2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 165/6, datë 26/06/2012 dërguar **Z. Ardian Fullani, Guvernator i Bankës së Shqipërisë**, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

1. Nga auditimi për disa vite i rregullshmërisë së përcaktimit dhe kalimit të “Fitimit neto të Bankës së Shqipërisë” në buxhetin e shtetit, sipas kriterëve të nenit 10, pika 2 e ligjit nr. 8269, datë 23/12/1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në të cilin përcaktohet: “Fitimi neto për vitin financiar që mbetet pasi bëhen zbritjet, sipas neneve 8 e 9 dhe të pikës 1 të këtij neni, kalon në të ardhurat e buxhetit të shtetit brenda 4 muajsh, pra deri më datën 30 prill të vitit pasardhës” dhe të kriterëve të marrëveshjes midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave, lidhur më 27/3/2003, ku në pikën 4.2 të saj përcaktohet: “Transferimi i fitimit të Bankës Shqipërisë, bëhet me kërkesë të Ministrisë së Financave dhe jo më shpejt se data 7 e çdo muaji në formë paradhënie. Transferimi do të fillojë në muajin shkurt dhe do të përfundojë në muajin janar të vitit pasardhës. Masa e fitimit të derdhur nuk do të tejkalojë vlerën 90 % të fitimit të realizuar”, janë konstatuar:

- Mangësi në zbatimin e aktmarrëveshjes për numrin e kalimeve të fitimit paradhënie, mospërputhje të shumës së kërkuar nga Ministria e Financave me sasinë e transferimit nga Banka e Shqipërisë, kalime nga Banka e Shqipërisë të fitimit paradhënie gjatë vitit, pa përcaktuar Ministria e Financave shumën e kërkuar. Mospërputhje midis neneve të ligjit dhe neneve të aktmarrëveshjes të sipërcituar, sepse ligji e përcakton shpërndarjen e fitimit, **pasi del rezultati vjetor** dhe pasi bëhen zbritjet, ndërsa aktmarrëveshja e përcakton kalimin e fitimit neto të Bankës së Shqipërisë në buxhetin e shtetit çdo muaj të vitit, deri në 90% të fitimit të realizuar.

Meqë rinovimi i aktmarrëveshjes ekzistuese ka filluar, por nuk është përmbyllur akoma, **rekomandojmë që:**

- Rinovimi i aktmarrëveshjes ekzistuese midis dy institucioneve, të ketë parasysh përputhjen e neneve të ligjit nr. 8269, datë 23/12/1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të neneve të aktmarrëveshjes së lidhur midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave, nene të cilat përcaktojnë transferimin e “Fitimit neto të Bankës së Shqipërisë” në llogarinë e “Depozitës së Qeverisë”.

Deri më 30/09/2012

2. Nga auditimi i zbatimit të marrëveshjes së lidhur “Për emetimin nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë të obligacioneve në formë regjistrimi” midis Bankës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Guvernatori dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministri i Financave, ka rezultuar se nga Ministria e Financave në një ankand obligacioni është tejkalluar shuma e shpallur për emetim, në kundërshtim me nenin 14, pika 2 të marrëveshjes. Marrëveshja në fuqi nuk ofron mundësi për rritje të shumave të shpallura para ankandit. Për sa më sipër, për të saktësuar hapësirat e mundshme të huamarrjes nga Ministria e Financave të përcaktuara në marrëveshje, në varësi të nevojave për huamarrje me kosto sa më të ulët, trajtuar në faqen 12 të raportit, **rekomandojmë që:**

- Nga Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me Ministrinë e Financave të bëhet plotësimi i nenit 14, pika 2, si më poshtë:

“Gjithashtu, Ministria e Financave referuar nevojave të huamarrjes me koston më të ulët, ka të drejtën e kompensimit të shumave të shpallura për emetim para ankandit për lloje të ndryshme ankandesh obligacioni, të cilat realizohen në një ditë”.

Menjëherë

3. Referuar konstatimit se nga Ministria e Financave për nevoja të huamarrjes gjatë vitit 2011, është rihapur ankandi nr. 19 i obligacioneve 5/vjeçare, mbështetur kjo në të drejtën e rihapjes të këtyre ankandëve, përcaktuar në marrëveshjen e lidhur “Për emetimin nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë të obligacioneve në formë regjistrimi”, nënshkruar më datë 28/9/2007, të ndryshuar, mbështetur gjithashtu dhe në argumentimet e dhëna nga Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave mbi arsyet e rihapjes së ankandëve të obligacioneve, të cilat nuk janë të përfshira në marrëveshjen e mësipërme, **rekomandojmë që:**

- Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, të përcaktojnë në nenin 2, të marrëveshjes “Për emetimin nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë të obligacioneve në formë regjistrimi”, llojin e obligacionit që do të rihapet dhe kushtet që duhet të plotësojë një ankand obligacioni për t’u rihapur, për një menaxhim më efektiv të borxhit të brendshëm me instrumente afatgjatë.

Menjëherë

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Nga auditimi i zbatimit të marrëveshjes së lidhur “Për emetimin nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë të obligacioneve në formë regjistrimi”, midis Bankës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, ka rezultuar se nga komisioni i zhvillimit të ankandeve, jo për të gjitha rastet e ankandeve të obligacioneve janë mbajtur procesverbalet për pjesëmarrësit që dorëzojnë kërkesën në kutinë postare, me argumentin që s’ka pasur kërkesa nëpërmjet postës. Për sa më sipër, me synimin e konfirmimit të procesit të kryerjes së kontrollit të postës nga komisioni i ankandit për ekzistencën ose jo të kërkesave të paraqitura në formë shkresore në BSH dhe të marra në konsideratë, sipas përcaktimeve në marrëveshje, **rekomandojmë që:**

- Në Bankën e Shqipërisë në rregulloren e brendshme të funksionimit të komisionit për zhvillimin e ankandeve të obligacioneve, të shtohet detyrimi që ky komision duhet të mbajë procesverbal edhe në rastet kur nuk janë paraqitur kërkesa për pjesëmarrje në ankandet e obligacioneve, duke konfirmuar këtë fakt.

Menjëherë

2. Departamenti i Kontabilitet dhe Financës, të marrë masa për zbatimin dhe kontabilizimin e Vendimit të Këshillit Mbikqyrës nr. 66, datë 14/9/2011 “Për sistemimin e diferencave të rezultuara nga inventarizimi fizik i aktiveve të qëndrueshme në Bankën e Shqipërisë”, pika 2 e tij, ku përcaktohet që, diferencat të kalojnë në llogaritë e klasës 4, me emërtimin “Diferenca të rezultuara nga inventari në ndjekje për t’u mbyllur”, në zbatim të udhëzimit “Mbi procedurat e nxjerrjes së urdhër zhdëmtimeve në Bankën e Shqipërisë”, për “Aktive të qëndrueshme të trupëzuara”, në 143 artikuj, **me vlerë fillestare 6,883,037.40 lekë dhe me vlerë të mbetur 709,128.18 lekë.**

Deri më 31/7/2012

3. Departamenti i Kontabilitetit dhe Financës, me vendim të Këshillit Mbikqyrës të marrë masa për sistemimin dhe kontabilizimin e llogarisë “Të tjera llogari për t’u marrë”, nënlllogaria “T.v.sh. për shitjen e katalogjeve dhe monedhave numizmatike”, **në vlerë 1,358,974.40 lekë**, shumë e krijuar që në vitin 2003, për sasinë e katalogjeve të kartmonedhave dhe monedhave numizmatike të dhuruara apo shitura pa t.v.sh., prodhim i vitit 2002.

Deri më 31/7/2012

4. Departamenti i Kontabilitetit dhe Financës, me vendim të Këshillit Mbikqyrës, të sistemojë në kontabilitet dhe të kalojë në të ardhura të institucionit, **shumën prej 140,751.44 lekë**, diferencë në portofolin e kredive dhënë punonjësve, ardhur nga

mospërputhja e programeve të regjistrimit dhe kontabilizimit të tyre midis programit të ri të regjistrimit kontabël dhe programit të vjetër.

Deri më 31/7/2012

5. Departamenti Juridik, në bashkëpunim me Departamentin e Kontabilitetit dhe Financës, të shikojnë mundësinë për t'ju drejtuar edhe një herë Zyrës së Përmbartimit Tiranë, për të mundësuar shlyerjen e kredisëtë marrë nga dy ish punonjës të Bankës së Shqipërisë, ***në vlerë 8,300,000 lekë***, përkatësisht [REDACTED] në shumën 4,300,000 lekë dhe [REDACTED] në shumën 4,000,000 lekë.

Deri më 31/7/2012

6. Nga auditimi i procedurave të prokurimit konstatohet se, përsëriten në mënyrë të përvitshme procedurat për kontratat e shërbimit në Bankën e Shqipërisë, përsëritje të cilat janë specifike për këtë institucion, të cilat kanë sjellë për pasojë *vonesa dhe ndërprerje* të këtyre shërbimeve dhe *rritje të shpenzimeve* për kryerjen e procedurave. Lidhja e kontratave të shërbimit me afate më të gjatë se një vit, reflekton impakt pozitiv në konsolidimin dhe menaxhimin më të efektshëm të shërbimit të ofruar dhe sigurimin e vazhdimësisë normale të aktivitetit, megjithëse në nenin 45 “Kërkesat për prokurim”, Kreu VIII, i Rregullores “Për Procedurat e Prokurimit në Bankën e Shqipërisë”, të miratuar me Vendimin nr. 81, datë 15/11/2006 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës Shqipërisë, të ndryshuar, ku shprehet se: “Enti Prokurues për shërbime që kërkohen të shtrihen në vitet kalendarike prokuron sipas vlerës së plotë, me miratimin e Këshillit Mbikëqyrës nëpërmjet kontratave me kohëzgjatje më shumë se një vit kalendarik”. Deri më sot Kryetari i Entit Prokurues nuk ka marrë iniciativë t’i propozojë Këshillit Mbikëqyrës të Bankës Shqipërisë për përdorimin e kontratave shumëvjeçare.

Përsa më lart, **rekomandojmë që:**

- Lidhjen e kontratave me afat më të gjatë se një vit, për shërbimet që përsëriten vit pas viti, të renditura si: Riabonimi në shërbimet e kompanisë Reuter, shërbimi postar në BSH, shërbimi i vendosjes dhe ruajtjes së repetitorëve të sistemit të radiondërlidhjes, shërbimi i lidhjes online ndërmjet godinave të BSH në Tiranë dhe me degët e saj, lidhja me rrjetin Secure IP Network (SIPN) të kompanisë SWIFT, shërbimi i mirëmbajtjes dhe riparimit të fotokopjeve të tipit toshiba, suporti për database Oracle, mirëmbajtja dhe riparimi i sistemeve sortuese, mirëmbajtja e sistemit të menaxhimit të thesarit Inforex Loro, mirëmbajtja e sistemit IDBS, mirëmbajtja e aplikimit të sistemit AIPS dhe AECH, rinovimi i licencave të programit të arkivues elektronikë, shërbimi i mirëmbajtjes së motor gjeneratorëve, mirëmbajtja e sistemeve ClearSwift, riabonimi në modulën e trajnimit të mbikëqyrjes FSI-Connect etj.

Deri më 31/7/2012

7. Nga Sektori i Prokurimit, të merren masa që në dokumentacionin e dosjes së prokurimit, të dokumentohen evidentimi i ankesave, kthimi i përgjigjeve dhe zgjidhja e tyre, mbajtja e proces-verbaleve përkatëse për ankesat dhe mënyra e zgjidhjes së tyre, protokollimi dhe bashkëngjitja e këtyre dokumenteve në dokumentacionin e dosjes së prokurimit.

Menjëherë

8. Të shtohet në nenin 46, të Rregullores të Bankës së Shqipërisë, të “Nxjerrja e urdhrin të prokurimit”, Kreu VIII, “Realizimi i Procedurës së Prokurimit”, në urdhrin e Prokurimit, duhet të përfshihet klasifikimi “Sekret Bankarë”, për rastet kur kemi të bëjmë me dokumente të klasifikuar “sekret”.

Deri më 31/7/2012

9. Nga auditimi i praktikave në dosjet e prokurimit është konstatuar se, nuk arkivohen në to dokumentet e lidhjes së kontratave, ndjekja dhe zbatimi i tyre, duke mos zbatuar nenin 53, të Rregullores të Bankës së Shqipërisë “Shpallja e ofertës fituese dhe njoftimi i ofertuesit fitues”, paragrafi i fundit “*Me nënshkrimin e kontratës, dosja e plotë e dokumenteve të prokurimit dhe një kopje e kontratës depozitohet në Arkivin e Bankës së Shqipërisë, ku ruhet dhe administrohet.*

Për këtë, **rekomandojmë që:**

- Të arkivohen në dosjet e prokurimit *dokumentet e zbatimit të kontratës*, pra në dosjen e prokurimeve të arkivuara duhet të bashkëngjiten dhe dokumentacioni që rrjedh nga zbatimi i kontratës, deri në likuidimin e plotë, si proces verbalet që mbahen për ndryshimet që i bëhen preventivit dhe projektit bazë, aktet e kontrollit dhe marrjes në dorëzim të ndërtimeve, shërbimeve, mallrave etj.

Menjëherë

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Nërënxa Llapashtica, Nikoleta Piranian, Evis Çela dhe Vasil Vane. Më tej u shqyrtua nga Kryeaudituesi i Departamentit zj. Luljeta Nano, Drejtori i Departamentit z. Ded Trieshi dhe Juristi i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë z. Koço Sokoli (në mungesë të Drejtorit të Drejtorisë dhe me porosi), si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm z. Robert Gjini.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT